

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	00 Nr.59/2025	Data: 28.03.2025	

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) dhe neni 40 paragrafi 40.2 pika e) të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, nr.28/2008) dhe në pajtim me nenin 33. Paragrafi 33.1. pika 5) të Statutit të Komunës 01 Numër 62/10 dhe nenit 13 të Rregullores Nr. 1/2022 për Ndarjen e Bursave për Studentë, në mbledhjen e mbajtur më: 28.03.2025 mori këtë:

V E N D I M
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE PËR
NDARJE TË BURSIVE

1. Formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave ndaj komisionit vlerësues të ndarjes së bursave, në komision emërohen:

1. z. Arben Kabashi drejtor i drejtorisë për Administratë nga ekzekutivi, kryesues
2. z. Kushtrim Buleshkaj drejtor i drejtorisë për Inspeksion nga ekzekutivi, anëtar,
3. znj. Liridona Lajçi, nga radhët e LDK-së, anëtare,
4. znj. Ardita Idrizaj, nga radhët e AAK-së, anëtare,
5. z. Endrit Mehmetaj, nga shoqëria civile anëtar.

2. Komisioni i cekur më lartë, në pajtim me Rregulloren Komunale Nr.1/2022 për Ndarjen e Bursave, do të bëjë shqyrtimin e të gjitha ankesave ndaj komisionit vlerësues dhe do të kryej të gjitha punët e caktuara me rregullore dhe ligj.

3. Obligohet Drejtoria për Arsim që t'i kryej të gjitha punët administrativo - teknike të domosdoshme për komision.

4. Ky Vendim hynë në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Komunës.

5. Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria i Arsimit, Ministra e Administratës së Pushtetit Lokal, anëtarët e komisionit dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.

11

00 Nr./Br. 033-97 Nr. i faq./Br.str. 01

Data/Datum 03 09 / 2025

ISTOG - ISTOK

Kryesuesi i Kuvendit

z. Enver Rugova

ERugova